



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 03-03/DPK	Nr. Prot. 01-1200/16
Dep. 03	Br. Prot. 01-1200/16
Dep. 03	Prot. No. 01-1200/16
Broj stranica 03	Data 22-03-2016
Nr. pages 03	Date 22-03-2016

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATE/A:	22.03.2016
REFERENC-Ë:	DPK- DPKPP-03-03/1069/16
PËR/ZA/TO:	znj. Arberita TAFILAJ, u.d. Drejtoreshë e Divizionit për Prokurimin Publik në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
CC:	z. Alush ISTOGU, Sekretar i Përgjithshëm i MASHT-it
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Furnizim me ushqim për nxënës në qendra burimore dhe shkolla speciale "

**E nderuara znj. Tafilaj ,**

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin " Furnizim me ushqim për nxënës në qendra burimore dhe shkolla speciale " me numër prokurimi: MASHT-208-16-003-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Furnizim me ushqim për nxënës në qendra burimore dhe shkolla speciale " me numër prokurimi: MASHT-208-16-003-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të ligjit nr. 05/l -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-237.



### *Arsy etimi*

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 14.03.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli AKK-03-3-1069/16 për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull " *Furnizim me ushqim për nxënës në qendra burimore dhe shkolla speciale* " me numër prokurimi: MASHT-208-16-003-121, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Agjencia duke vepruar sipas detyrës zyrtare e ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim.

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 14.03.2016, ka paraqitur kërkesë për dokumentacion ku ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që ta dorëzoj në Agjenci tërë dokumentacionin për këtë procedurë të prokurimit para hapjes së tenderit. Autoriteti kontraktues me datë 15.03.2016 ka dorëzuar tërë dokumentacionin e kërkuar. Agjencia pasi ka trajtuar tërë dokumentacionin në dispozicion dhe e ka analizuar të njëjtin ka konstatuar faktet si në vijim:

Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë krijimin e kontratës publike kornizë të llojit furnizim në procedurë të hapur, ku ka paraparë furnizimin me artikuj ushqimor për 5 Qendra burimore dhe 2 Shkolla Speciale.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes dosjen e tenderit vëren se dosja e tenderit standarde e aprovuar nga KRPP për kontratën furnizim - procedurë e hapur, për këtë aktivitet të prokurimit është modifikuar në kundërshtim me ligjin. Nëse i analizojmë dy kolonat e fundit të dosjes së tenderit vërehet se kolona tek çmimi total me TVSH dhe vendi i origjinës janë hequr nga dosja standarde e aprovuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Nuk ka përputhje në mes listës së çmimeve nga dosja e certifikuar në KRPP dhe listës së çmimeve në dosjen e cila i'u është përgatitur nga Autoriteti kontraktues.

Në Dosjen e Tenderit që ka përgatitur Autoriteti Kontraktues më saktësisht tek pjesa II përshkrimi i çmimeve nga pozicioni 1 deri në pozicionin 91 sasitë e përafërta janë plotësuar vetëm me numrin 1 dhe në këtë mënyrë nuk janë paraparë sasitë e përafërta e që konsiderojmë se ky veprim i Autoritetit kontraktues bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Sipas ligjit nr. 05/1 -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237 në nenin 22 është paraparë që "sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se *plus/minus* tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër-blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%). pa



marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.”

Bazuar në rregulloren për prokurim publik neni 26 paragrafi 1, 2 dhe 3 Autoriteti kontraktues duhet të specifikoj sasi të gjatë përgatitjes së materialit tenderues, po ashtu në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasi të mund të mos jenë të parashikuara në mënyrë precize, duhet të bëhet një parashikim i përafërt i sasive. E jo si në rastin e Autoritetit Kontraktues ku përveç përshkrimit të artikujve nuk ka asnjë përshkrim tjetër të sasive përveç numrit 1, sasia është e pa definuar. Pastaj gjatë vlerësimit të ofertave vlera e përgjithshme e kontratave ose vlera e parashikuar e kontratës kornizë duhet të kalkulohet në bazë të çmimeve të artikujve duke shumëzuar me sasi të relevante ose sasi të përafërta të kërkuara në dosjen e tenderit.

Tek pika 14.1. e dosjes së tenderit pjesa e sigurisë së ekzekutimit është kërkuar shuma e sigurisë së ekzekutimit të kontratës të jetë 10 % e vlerës se paraparë të kontratës në kohëzgjatjen prej 15 muaj, kërkesë kjo për të cilën gjithashtu konsiderojmë se bie ndesh me udhëzuesin operativ për prokurimin publik më saktësisht me nenin 27 pika 6 dhe 7 ku thuhet se ” *Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Sigurimi i ekzekutimit do të lirohet dhe do të kthehet OE, brenda 30 ditë, pas kompletimit të kontratës*”.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit e Ligjit Nr.04/L-042 për prokurimin publik, nenin 22 ligjit nr. 05/l -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-237, nenin 26 Sasi të lidhje me kontratat për mallra, punë dhe shërbime të Rregullores për Prokurimin Publik dhe me nenin 27 të udhëzuesit operativ për prokurimin publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikën e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë kundër Korrupsionit për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !